



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**DREJTORIA E ARSIMIT, KULTURËS, TURIZMIT, RINISË DHE SPORTIT**

**Databaze e burimeve turistike në Bashkinë Vau Dejës**

**Lista e monumenteve të kulturës Bashkia Vau Dejës**

Lista e monumenteve të kulturës Bashkia Vau Dejës							
					Adresa		Të dhënat e shpalljes
Nr	Emërtimi	Statusi	Kategoria	Nën kategoria	Fshati	Nj. Admistra	Institucioni/ nr vendim/ data
1	Kalaja e Vigut	Monument kulture i kategoris I	Turizmi i Kulturës	Historik Arkeologjik	Vig	Vig-Mnel	1. Instituti i Shkencave/ nr. 95/ dt.16.10.1948 2.Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës/ nr. 6/ dt. 15.01.1963 3.Ministria e Arsimit dhe Kulturës/nr.1886/ dt.10.06.1973
2	Kalaja e Vau Dejës	Monument kulture i kategoris I	Turizmi i Kulturës	Historik Arkeologjik	Vau-Dejës	Vau-Dejës	1. Instituti i Shkencave/ nr. 95/ dt.16.10.1948 2.Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës/ nr. 6/ dt. 15.01.1963 3.Ministria e Arsimit dhe Kulturës/nr.1886/ dt.10.06.1973
3	Kalaja Shurdhah (Sarda)	Monument kulture i kategoris I	Turizmi i Kulturës	Historik Arkeologjik	Vjerdhë	Hajmel	1. Instituti i Shkencave/ nr. 95/ dt.16.10.1948 2.Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës/ nr. 6/ dt. 15.01.1963 3.Ministria e Arsimit dhe Kulturës/nr.1886/ dt.10.06.1973
4	Kalaja e Sapës	Monument kulture i kategoris I	Turizmi i Kulturës	Historik Arkeologjik	Nënshat	Hajmel	1. Instituti i Shkencave/ nr. 95/ dt.16.10.1948 2.Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës/ nr. 6/ dt. 15.01.1963 3.Ministria e Arsimit dhe Kulturës/nr.1886/ dt.10.06.1973.

5	Kalaja e Dalmacës	Monument kulture i kategoris I	Turizmi i Kulturës	Historik Arkeologjik	Koman	Temal	1.Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës/ nr. 6/ dt. 15.01.1963 2.Ministria e Arsimit dhe Kulturës/ nr.1886 /dt.10.06.1973
6	Rrënojat e kishës së Shën Markut në kalanë Vau-Dejes	Monument kulture i kategoris I	Turizmi i Kulturës	Historik Arkeologjik	Vau-Dejes	Vau-Dejes	Ministria e Arsimit dhe Kulturës/ nr. 786/1/ dt.05.11.1984
7	Rrënojat e kishës së Shën Mëhillit në kalanë e Sapës	Monument kulture i kategoris I	Turizmi i Kulturës	Historik Arkeologjik	Nënshat	Hajmel	Minis. e Arsim. dhe e Kulturës (D.K)/ nr.786/1 dt.05.11.1984
8	Varreza e lazhtë e Komanit	Monument kulture i kategoris I	Turizmi i Kulturës	Historik Arkeologjik	Koman	Temal	1.Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës/ nr. 6/ dt. 15.01.1963 2.Ministria e Arsimit dhe Kulturës/ nr.1886 /dt.10.06.1973
9	Banesa e shkrimtarit Z. Martin Camaj	Monument kulture i kategoris I	Turizmi i Kulturës	Historik Arkeologjik	Telum	Temal	M.T.K.R.S.(Sektori Kult.Kombëtare)/ nr.391. dt.14.06.2007
10	Kisha e Shën Mërisë	Monument kulture i kategoris I	Turizmi i Kulturës	Fetar	Vau-Dejes	Vau-Dejes	1.Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës/ nr. 6/ dt. 15.01.1963 2.Ministria e Arsimit dhe Kulturës Drejtoria e Kultures /nr. 68/7/ dt.30.05.1970
11	Rrënojat e qëndres zëjtare të punimit të armeve në Hajmel	Monument kulture i kategoris I	Turizmi i Kulturës	Burime të tjera kulturore	Hajmel	Hajmel	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës/ nr. 2509/1/dt. 30.06.1983

## Lista e Zonave te Mbrojtura Bashkia Vau Dejes

					Adresa		Te dhenat e shpalljes
Nr	Emertimi	Statusi	Kategoria	Nen kategoria	Fshati	Nj. Admistra	Institucioni/ nr vendim/ data
1	Zona arkeologjike "A" dhe "B" e vendbanimit të Komanit (Dalmacija e vjetër) dhe rregullorja e administrimit	Zonë e mbrojtur	Turizmi i Kulturës	Historik Arkeologjik	Koman	Temal	Vendim i Këshillit të Ministrave /nr.786/ dt.22.09.2015
2	Zona e mbrojtur e kompleksit "Ndre Mjeda " kishë-qelë	Zonë e mbrojtur	Turizmi i Kulturës	Trashigimi	Kukël	Bushat	M.T.K.R.S.-Drejtoria e Pergjithshme e Turizmit dhe trashigimise kulturore /nr. 53/ dt.22.02.2012
3	Zona e mbrojtur e Rrënojave të kishës së Sapës	Zonë e mbrojtur	Turizmi i Kulturës	Historik Arkeologjik	Nënshat	Hajmel	Ministria e Kulturës/ nr. 242/ dt 19.07. 2016

## Lista e Monumenteve te natyres Bashkia Vau Dejes

					Adresa		Te dhenat e shpalljes
Nr	Emertimi	Statusi	Kategoria	Nen kadegoria	Fshati	Nj. Admistra	Institucioni/ nr vendim/ data
1	Fragment i thyrjes tektonike shkoder-peje (karmë)	Monument natyre i kategoris III	Turizmi i natyres	Burime të tjera natyrore	Karmë	Vau-Dejes	VKM 676 Datë 20.12.2002
2	Guri I Lekës	Monument natyre i kategoris III	Turizmi i natyres	Burime të tjera natyrore	Malagji	Temal	VKM 676 Datë 20.12.2002
3	Bliret në Lisniqe	Monument natyre i kategoris III	Turizmi i natyres	Burime të tjera natyrore	Lisniqe	Temal	VKM 676 Datë 20.12.2002
4	Shpella e Melagjisë	Monument natyre i kategoris III	Turizmi i interesit të veçantë	Speleologji	Malagji	Temal	VKM 676 Datë 20.12.2002
5	Fusha e Liqethit	Monument natyre i kategoris III	Turizmi i natyres	Burime të tjera natyrore	Lekgegaj	Shllak	VKM 676 Datë 20.12.2002

## Lista e Atraksioneve kulturore & natyrore Bashkia Vau Dejes

					Adresa		Te dhenat e shpalljes
Nr	Emertimi	Statusi	Kategoria	Nen kadegoria	Fshati	Nj. Admistra	Institucioni/ nr vendim/ data
1	Kisha në fshatin Kaçë	Atraksion kulturor	Turizmi i Kulturës	Fetar	Kaçë	Vau-Dejes	
2	Liçeni I Vaut te Dejes	Atraksion natyror	Turizmi i natyres	Burime të tjera natyrore	Vau-Dejes	Vau-Dejes	
3	Liçeni I Komanit	Atraksion natyror	Turizmi i natyres	Burime të tjera natyrore	Koman	Temal	
4	Shtëpia lutjes “Shen Jozefi” Karmel	Atraksion Kulturor	Turizmi i kultures	Fetar	Nënshat	Hajmel	
5	Muzeu Dioqezan Sapa	Atraksion Kulturor	Turizmi i kultures	Fetar	Vau-Dejes	Vau-Dejes	
6	Zoja e Lurdit	Atraksion kulturor	Turizmi i kultures	Fetar	Koman	Temal	
7	Kisha e Barbullushit	Atraksion Kulturor	Turizmi i kultures	Fetar	Barbullush	Bushat	
8	Qendra Kulturore “Gjin Shkoza”	Atraksion Kulturor	Turizmi i kultures	Burime të tjera kulturore	Vau-Dejes	Vau-Dejes	

**Shënim: Kisha e Kaçës është në proces të shpalljes Monument Kulture.**

**Shënim: për rrenojat e Kishës së Shën Mëhillit, Shtëpia lutjes Shën Jozefi karmel, Muzeu Sapa, Zoja e Lurdit dhe Kisha Barbullush nuk ka informacion.**

Burime informacioni:

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Date. 18/10/2017 <http://www.mjedisi.gov.al/>

Instituti i Monumenteve te Kultures Date 18/01/2018 [http://imk.gov.al/site/?page\\_id=9](http://imk.gov.al/site/?page_id=9)

Agjensia Kombetare e Zonave te Mbrojtura


[http://akzm.gov.al/index.php?option=com\\_content&view=featured&Itemid=101&lang=en](http://akzm.gov.al/index.php?option=com_content&view=featured&Itemid=101&lang=en)

## 1. Kalaja e Vigut

Monument kulture kategoria I, i shpallur me vendim Nr. 93 dtatë. 16.10.1948/Nr. 6 datë. 15.01.1963/Nr. 1886 datë. 10.06.1973

Fusha: Arkeologji; Gjinia: Vendbanim; Tipologjia: Kala shek.I

Njësia administrative: Vig-Mnel, Vendodhja: Vig



**Fig. 1: Pamje nga Kalaja e Vigut**

Kalaja e Vigut është një ndër tri kalatë (castrumet) ushtarake romake në territorin Shqipëtar. Ajo është një kështjellë ushtarake dhe me funksion ekonomik. Është ndërtuar mbi rrugën e rëndësishme ushtarake-tregtare Lisus-Naisus (Lezhë-Nish) dhe pikërisht në kryqëzimin e saj me rrugën që lidhte Shkodrën me Oroshin dhe Lezhë-Pukë-Prizren, rrugë kjo që me kalimin e kohës është rrënuar dhe është bërë e pashfrytëzuar. Saktësisht kalaja, graviton në një sheshore, ku bashkohet lumi i Gjadrit me atë të Vomës, me një sipërfaqe prej 5600 metrash katrorë. Kështjella ka formën e një katërkëndëshi të çrregullt me brinjë 75-98 m dhe është pajisur me 12 kulla. Katër kullat e këndeve kanë formën e një freskoreje, të ngjashme me ato të Elbasanit. Themelet e mureve rrethuese mund të shihen gjatë anëve të këndit që formon derdhja e përroit të Vomës në atë të Gjadrit. Teknika e ndërtimit të mureve karakterizohet me përdorimin e gurëve të zallit të lidhura me llaç, fugaturat e gjera në mes mureve kanë të vendosura copa tjegullash ose tulla për të mbushur boshllëqet. Shtretërit e thellë që kanë hapur këta dy përrenj në tokën e butë fushore përbëjnë hendeqet (transhetë) natyrore të qytetit. Në pjesën e brendshme gjenden gjithashtu shumë mure themelesh, por asnjë që të ketë lidhje me ndërtesa të mëdha ose kisha.

Ky tip kështjelle për garnizone fillon shumë më herët, duke nisur që nga periudha e Dioklecianit. Këto kështjella ndërtoheshin në zona kryesisht fushore, pranë luginave të lumenjve.

Në zonën e kalasë së Vigut, pranë varrezave ndodhet një kishë e vjeter ku thuhet se ka shërbyer Ndre Mjeda.

## 2. Kalaja e Danjës, Vau Dejes

**Monument kulture kategoria I, i shpallur me vendim Nr. 93 dtatë.16.10.1948/Nr. 6 datë: 15.01.1963/ Nr. 1886 datë. 10.06.1973**

**Fusha: Arkeologji; Gjinia: Vendbanim; Tipologjia: Kala shek.XIV**

**Njësia administrative: Vau-Dejes, Vendodhja: Vau-Dejes.**



**Fig. 2: Pamje nga Kalaja e Vaut të Dejes**

Kalaja e Danjës, ndodhet mbi një kodër shkëmbore rreth 120 metër mbi nivelin e detit. Thuhet që është pika ku ndriçon dielli 3 herë më shumë se në Londër (kalon paraleli 42). I përket periudhës mesjetare të shekullit XIV. Ajo kontrollonte lehtësisht komplet fushën pjellore të Zadrimës dhe rrugët kryesore që vinin nga Shkodra dhe Lezha, të cilat bashkoheshin tek dogana e Danjës, duke vazhduar drejt Kosovës e më larg.

Kalaja përmendet në dokumentat e shekullit të XII, që ishte një qendër episkopale dhe një nga qendrat më të rëndësishme të kohës që kontrollonte rrugën Shkoder-Prizren. Kalaja mesjetare ishte pjesë e një sistemi fortifikimi të luginës së Shkodrës dhe luginës së Drinit.

Gjate viteve 80` të shekullit të fundit janë bërë disa gërmime arkeologjike që tregojnë vendndodhjen e sundimtarëve, familjes Zaharia. Kjo familje luante një rol të rëndësishëm në ngjarjet që i përkasin periudhës së Skënderbeut. Sipas dokumentave veneciane kjo kala është përfunduar së ndërtuari para vitit 1400. Teknika e ndërtimit është ajo e përdorur nga kalatë e tjera mesjetare, gurë të përmasave të vogla, të skuadruar, të punuar me kujdes dhe të lidhur me llaç mes tyre duke ruajtur linjat e rregullta. Në këtë kala ekzistojnë edhe Kisha e Shën Markut dhe varrezat të cilat kanë vlera të larta kulturore dhe arkeologjike.

### 3. Qyteti Mesjetar i Sardës (Shurdhahu)

Monument kulture kategoria I, i shpallur me vendim Nr. 93 dtatë.16.10.1948/Nr. 6 datë.15.01.1963/Nr. 1886 datë. 10.06.1973

Fusha: Arkeologji; Gjinia: Fortifikim; Tipologjia: Kala shek.XI

Njësia administrative: Hajmel, Vendodhja: Vjerdh.



**Fig. 3: Pamje nga Kalaja e Shurdhahut**

Qyteti mesjetar Sarda, sot kalaja e Shurdhahut, ngrihet mbi një kodër shkëmbore në bregun e djathtë të lumit Drin, rreth 8 km në jug të qytetit të Shkodres. Dikur kjo kodër lidhej nëpërmjet një qafe të ulët me vargun e kodrave që shtriheshin në bregun jugor të këtij lumi, por me krijimin e liqenit artificial të hidrocentralit të Vau Dejes kodra e Shurdhahut u kthye në ishull. Në gërmallat e kësaj Kalaje ndodhej dikur qyteti i Sardes, i cili përmendet shpesh në dokumentat mesjetare të kohës.

Qyteza e Sardës deri në fund të shekullit XV ka qenë një qendër e rëndësishme kulturore dhe pikë takimi i tre kulturave kryesore të gjithë trevës së veriut, kulturës së Malësisë, të kulturës së Mirditës dhe të Zadrimës të cilat me karakteristikat e veçanta që i dallojnë nga njëra-tjetra u kanë rezistuar kohës dhe rrymave kulturore të huazuara nga pushtues të ndryshëm.



Për këtë qytezë kanë shkruar shumë studiues të huaj si Ippen, De Grandi, J. G. Hahn dhe studiues e arkeologë shqiptarë, të cilët e kanë vlerësuar si një mbartës të kulturës Ilire. Vetë emri i saj i transformuar në Shurdhah ka origjinë Ilire nga qyteti i Sardis. Në këtë fortifikim janë gjetur rrënojat e një kalaje të antikitetit të vonë të shekullit VI-VIII.

Sarda ka qenë një stacion pushimi në rrugën e vjetër të Dardanisë. Në vitin 877 ka qenë qendër e krahinës së Polatit që përfshinte malësitë në të dy anët e Drinit, nga Liqeni i Shkodrës deri në Kukës. Sarda në mesjetë shërbente si një qytezë përbri Drinit dhe një pikë ndërlidhëse me rrugën e vjetër Gjakovë-Shkodër. Lulëzimin më të madh qyteti i Sardës e pati në shek. XI. Rreth viteve 1184 ai u pushtua nga serbet, më vonë ka qënë nën juridiksionin e familjes feudale shqiptare të dugagjinëvë dhe më 1491 u pushtua nga turqit. Në këtë periudhë qyteti pëson një rënje të vazhdueshme deri sa, pas shek. XVII, emri i tij nuk përmendet më.

Në fillimet e mesjetës, Sarda ishte një qendër e rëndësishme Ipeshkvnore. Nga viti 1190 -1460 njihen 17 Ipeshkvij që kanë drejtuar jetën fetare të qytetit.

Muret mbrojtës e ndajnë qytetin në dy pjesë: në qytetin e sipërm që zë majen e kodrës dhe në të poshtëm që zë shpatin e saj nga veriu, lindja dhe jugu. Si muri rrethues i sipërm ashtu edhe ai i poshtëm janë pajisur me kulla që kanë formën e germës U, trekëndëshe dhe katërkëndëshe të vendosura jo në distance të barabarta. Krejt kalaja e Shurdhahut rrethon një sipërfaqe prej 4.7 ha. Gjithsej ruhen dy hyrje, njëra që të fut në qytetin e poshtëm dhe tjetra në të sipërmin. Që të dyja hyrjet mbrohen nga dy kulla anësore në formën e shkronjës U të vendosura pranë njëra tjetres. Kullat e shurdhahut në përgjithësi janë të vogla dhe me mure të hollë 0.6-0.7 m, muri rrethues nuk e kalon gjerësin 0.9 m. njëra nga kullat që ruhet mirë arrin lartësin 5 m.

#### 4. Kalaja e Sapës

Monument kulture kategoria I, i shpallur me vendim Nr. 93 dtatë.16.10.1948/Nr. 6 datë.15.01.1963/Nr. 1886 datë. 10.06.1973

Fusha: Arkeologji; Gjinia: Vendbanim; Tipologjia: Kala shek.II p.e.s

Njësia administrative: Hajmel, Vendodhja: Nënshat.



**Fig. 4: Pamje nga Kalaja e Sapës**

Qyteti ngrihej në brendësi të malit të Shën Mëhillit në një tarracë natyrore rreth 30 m pa mbërritur në majën e malit, duke i dhënë një mbrojtje të sigurtë ndaj sulmeve.

Dioqeza e Sapës ka një histori 950 vjeçare dhe ajo ndodhej brenda qytetit me të njëjtin emër i cili ishte dhe i fortifikuar. Pikërisht ky sistem mbrojtës njihej si Kalaja e Sapës. Të dhënat e para për këtë qytet i kemi nga Annuali i Selis së Shenjtë që në vitin 1062. Me rënjen e perandorisë bizantine nën sundimin e feudalëve latin në vitin 1204, në territoret e Shqipërisë së mesme e ato të veriut krijohen një sërë peshkopatash të reja të lidhura me perëndimin katolik, ku ato të veriut lidhen nëpërmjet kryepeshkopatës së Tivarit. Kështu kemi themelin e peshkopatës së Sapës në vitin 1291 e cila njihet nga burimet historike dhe si një fortifikim. Prej tyre mësojmë se selia e peshkopatës së Sapës ndodhej në malin e lartë të mbiemëruar dhe mali i Shën Mëhillit nga emri i katedrales së saj. Sistemi mbrojtës i kësaj peshkopate njihej si kalaja e Sapës, ku vendodhja e saj transmetohej edhe nga relacionet e udhëtarëve prej shek. XVII e këtej. Në terren vërehen përqëndrime të qeramikës mesjetare të fragmentuar.

Mbetjet e murit rrethues të kalasë janë të përmasave të mëdha në ndryshim nga pjesa e sipërme ku përdoren gurë të vegjël të lidhur mes tyre me llaç dhe gjenden struktura banimi deri në lartësinë 30-40 cm. Në lindje ruhet ende në këmbë struktura e kishës së Shën Mëhillit që arrin në lartësinë 1,5 m në anën perëndimore si dhe absida e cila ka një diameter 3,5m. Gjatësia e strukturës së kishës është 11,5 m dhe gjërësia 6,5 m. Pranë kishës gjendet një strukturë tjetër deri në lartësinë 80 cm me mure me gjërësi 50-60 cm.

## 5. Kalaja e Dalmacës

Monument kulture kategoria I, i shpallur me vendim Nr. 6 datë. 15.01.1963/Nr. 1886 datë. 10.06.1973

Fusha: Arkitekturë; Gjinia: Fortifikim; Tipologjia: Kala shek.V-VIII-IX

Njësia administrative: Temal, Vendodhja: Koman.



**Fig. 5: Pamje nga Kalaja e Dalmacës**

Kalaja e Dalmacës ndodhet në majë të malit, 600 m mbi nivelin e detit brenda zonës së banuar. Siti shtrihet në një territor që ka një sipërfaqe prej 2 ha dhe përbëhet nga niveli i mesëm i habitatit dhe ai i poshtëm. Siti shtrihet pothuajse paralel në vijë ajrore me neokropolin e vendbanimit.

Kalaja e Dalmacës u gjurmua për herë të parë nga konsulli francez në shkoder Degrand në 1899. Gërmimet e para aty u bënë nga albanologu i njohur J.Han.

Kalaja e Dalmacës i përket zonës së Komanit ku falë zbulimeve arkeologjike me tepër vlerë të këtyre ditëve të fundit, po klasifikohet si qendra e qyteterimit të Shqipërisë në Mesjetën e hershme.

Zona po kthehet në një pikë referimi për studimin e qytetërimit të Ballkanit perëndimor kontinental në periudhën e mesjetës së hershme, atyre që quhen shekujt e errët të historisë. Sipas arkeologëve, zbulimet dëshmojnë për herë të parë një informacion të mjaftueshëm për atë periudhë të qytetërimit.

Në kalanë e Dalmacës, shohim nivelin e mesëm të vendbanimit i cili ka në përbërje të tij zonën më intensive të gërmuar deri më sot. Ky nivel përfaqëson një zonë të dendur ndërtimesh të dokumentuara dhe një seri të konsiderueshme mureshe strukturash. Si fazë e parë e nivelit të mesëm të vendbanimit është fundi i periudhës antike. Ky vendbanim zë një sipërfaqe prej 105 m<sup>2</sup>. Muret ruhen në lartësinë nga 0.6 m deri në 1.2 m.

Niveli i poshtëm i vendbanimit zë një sipërfaqe prej 230m<sup>2</sup>. Muret ruhen deri në lartësinë 2.42 m. Trashësia e tyre shkon në 60 cm. Këto mure janë të punuara mirë me llaç dhe të fugatuar në mënyrë të rregullt. Ky nivel i vendbanimit mendohet të jetë më i voni ose i fundit, që shkon aty mes shekujve VIII-XII.

Zbulimi i një sërë vendbanimeve prej guri, përdorimi i metalit, ndërtimi i shumë kishave dhe varrimet e të vdekurve të cilat kryheshin me veshje e stoli, si dhe gjetja e monedhave, flasin qartë për zhvillim ekonomik i cili nuk është hasur më parë në asnjë vendbanim të hershëm në Shqipëri, madje as në Ballkanin perëndimor

## 6. Kisha e Shën Marku

**Monument kulture kategoria I, i shpallur me vendim Nr. 786/1 datë. 05.11.1984**

**Fusha: Arkitekturë; Gjinia: Objekt kulti-kishë; Tipologjia: Kishë shek.VIII-XV**

**Njësia administrative: Vau-Djes, Vendodhja: Vau-Dejes.**



**Fig. 6: Pamje nga Kisha e Shën Markut**

Kisha e Shën Markut është monument kulture i kategorisë I, është ndërtuar me një arkitekturë të veçantë që i përket periudhes mesjetare dhe ndodhet në majën e malit të Dejës buzë murit lindor rrethues të kalasë së Vaut të Dejës, qyteza e dikurshme e Danjës

Kisha përmendet së pari në dokumentacionin historik në vitin 1400. Kështu Gjergj Bardhi në viziten e tij të viteve 1631-1632, flet ripërtritjen e kishës në atë periudhë. Kjo Kishë është e lidhur me gojdhënëen se e ka ndërtuar Skënderbeu si kujtim për fitoret e tij ndaj venecianëve për kalanë e Danjës. Pothuajse të gjitha burimet historike, deri vonë, deri në shekullin XX, përmendin dy gjëra të rëndësishme të qytezës mesjetare: kështjellën që i ishte blatur Shën Markut, shenjtit mbrojtës të Venedikut dhe kisha e Shën Mërisë, një kishë që ishte ndërtuar në shekullin XIII.

Dyshemeja e kishës është e shtruar me rrasa guri të formave të çrregullta. Kisha është nënshtruar disa restaurimeve që dallohen nga teknika e ndërtimit. Muri perëndimor përfundon me fronton dhe ka gjurme suvatimi. Monumenti ruhet me mure pa këmbë dhe pa çati, plan-drejtëndësh.


Datimi i kishës mendohet se i takon shekullit të XIII-XIV, ndërsa muri është i ndërtuar me gure të skuadruar. Teknika e ndërtimit në fazën e parë është me gurë të çrregullt të lidhur me llaç-gelqereje e të mbushur me rërë të trashë. Muri i fazës së dytë është i ndërtuar me gurë të skuadruar, të rreshtuar drejt, të lidhur me llaç mes tyre dhe me fugaturë të mirë. Në disa fragmente janë përdorur tjegulla në pjesën e fugave.

## 7. Varreza e Lashta e Komanit

**Monument kulture kategoria I, i shpallur me vendim Nr. 6 datë. 15.01.1963/Nr. 1886 datë. 10.06.1973**

**Fusha: Arkeologji; Gjinia: Vendbanim; Tipologjia: Banesa shek.VI-IX**

**Njësia administrative: Temal, Vendodhja: Koman.**



**Fig. 7: Pamje nga Varrezat e Komanit**

Nekropoli merr emrin nga ai i fshatit ku ndodhet të Njesisë Administrative Temal dhe është shpallur Monument Kulture i kategorisë së I me vendim nr.6 dt.15.01.1963 dhe vendim nr. 1886 datë 10/06/1973.Për nga rëndësia arkeologjike dhe të dhënat e përfuara nga gërmimet në kohë të ndryshe njihet dhe si Kultura e Komanit.

Ajo shtrihet në një kodër të lartë 586 m në pjesën më të butë të saj me drejtimin Lindje - Perendim.Ka një sipërfaqe prej 1 ha dhe deri me sot janë gërmuar dhe dal në drite mbi 150 varre.Kjo varrezë u gërmua për herë të parë në vitin 1898 nga Degrand e më pas ne 1902 nga Han dhe T.Ippen. Ndërkohë, fushata të gjëra gërmimesh nga arkeologë shqiptar janë zhvilluar gjatë viteve 1956,62,78-79,1986 që kanë vazhduar dhe në vitet e fundit.

Në bazë të gjetjeve, inventarëve të varreve dhe studimeve, kjo varrezë daton mes shekullit VI-IX. Shpërndarja gjeografike, tipologjia, inventari dhe kronologjia e njëjtë e këtyre varrezave i ka shtyrë studiuesit të identifikojnë në to kulturën e hershme mesjetare shqiptare, të quajtur "Kultura e Komanit" (shekulli VI-VIII).

Tipologjia e varreve, orientimi i tyre, inventari i armëve, i veglave të punës dhe i stolive, me praninë e elementëve të shumtë të simbolikës ilire, e lidhin "Kulturën e Komanit" me të kaluarën ilire të këtyre trojeve dhe me banorët e lashtë të tyre, ilirët. Ndërkohë që në shumë nga stolitë e gjetura në varreze e "Kulturës së Komanit" dallohet qartë mbijetesa e motiveve pagane (p.sh.

disku diellor), prania edhe e motiveve kristiane dëshmon se bartësit e "Kulturës së Komanit" ishin të besimit të krishterë.

Në shekekullin e VI-VIII, krishterimi i përhapur nga qendrat urbane, si Durrësi, Shkodra, Ohri etj, kishte mundur të depërtonte edhe në zonat e brendshme rurale, ku dëshmohet "Kultura e Komanit". "Kultura e Komanit", qoftë në trashëgiminë e saj të kulturës së lashtë ilire, qoftë me elementet e reja të periudhës së hershme bizantine, e në fund me shenjat e qarta të besimit të krishterë, është specifike për hapësirën ku dëshmohen shqiptarët në mesjetë. Ajo i dallon në mënyrë të qartë, bartësit e saj, shqiptarët, nga fqinjët e tyre të rinj e të vjetër, sllavët e grekët.

## 8. Banesa e Martin Camaj

Monument kulture kategoria I, i shpallur me vendim Nr. 391 datë. 14.06.2007

Fusha: Arkitekture; Gjinia: vendbanim; Tipologjia: vendbanim

Njësia administrative: Telum, Vendodhja: Temal.



**Fig. 8:** Pamje nga banesa e Martin Camaj

Banesa e shkrimtarit Martin Camaj gjendet në fshatin Telum të Njësisë Administrative Temal dhe është shpallur Monument Kulture i kategorisë së I me vendim nr.823, datë 18/05/2007.

Banesa ndodhet në një zonë të thellë të fshatit Telum të Temalit dhe arritshmëria e banesës është shumë e vështirë. Banesa është ndërtim 2 katësh, ka formë të rregullt drejtkëndore. Dritaret janë drejtkëndore me korniza guri të latuar, me përjashtim të dy prej të cilave janë të harkuara.

Banesa është pothuajse krejtësisht e degraduar, ruhet vetëm një pjese e mureve të jashtme. Nuk ruhen ndarjet e ndërkateve, dyert dhe dritaret. Banesa është e ndërtuar me mure guri të skuadruar. Çatia ka qenë prej druri por mungon mbules tani.



## 9. Kisha e Shën Mërisë, Vau Dejës

**Monument kulture kategoria I, i shpallur me vendim Nr. 6 datë. 15.01.1963/Nr. 68/7 datë. 30.05.1970**

**Fusha: Arkitekture; Gjinia: Objekt kulti-Kishë; Tipologjia: Kishë shek.VIII**

**Njësia administrative: Vau-Dejes, Vendodhja: Vau-Dejes.**



**Fig. 9: Pamje nga Kisha e Shën Mërisë (përpara shembjes)**

Kisha Shën Mërisë është ndërtuar në këmbë të malit të Dejës ku ndodhen rrënojat e qytezës dhe fortesës mesjetare të Danjës, që për herë të parë përmendet si qendër peshkopale në vitin 361. Në këtë Kishë thuhet se ka vënë kurorë Skenderbeu dhe në afërsi të saj ekziston varri i Lekë Zaharisë. Kisha Lindja e Zojës është një ndër Kishat më të vjetra në Shqipëri që i ka rezistuar shkatërrimeve ndër shekuj derisa rregjimi komunist e shëmbi plotësisht në vitin 1969. Kisha ka qenë e shtrirë përfundim Kalasë së Danjës, e ndërtuar në luginën e malit të Dejës dhe mendohet se është ndërtuar rreth viteve 1300.

Kisha e Shën Mërisë është ndërtim tipik i stilit Gotik të shekullit XIII. Kisha e Shën Mërisë paraqiste një kishë një nefshe me planimetri drejtkëndëshe dhe absidë rrethore në anën lindore. Në Kishë hyhej nga porta e vetme e saj e vendosur në anën perëndimore. Muret e kishës ishin të ndërtuar me gurë gëlqëror të gdhendur të lidhur me llaç gelqereje me fuga të holla. Brendësia e kishës paraqiste një vëllim të mbuluar me qemer cilindrikë me prerje harqesh të mprehtë, që mbështetëshin në një sistem harqesh mbajtës, harqesh të verbër dhe pilastrash. Me ritmin e tyre kjo tërësi pilastrash dhe harqesh me një qëndrueshmeri statike përcaktonte edhe organizimin hapsinor të brendësisë së kishës e ndriçuar nga 6 dritare dhe e mbuluar me çati dyujëse me tjegulla vendi. Sot ruhen bri Kishës së re të ndërtuar pas viteve '90 vetëm themelet e Kishës së vjetër në lartësinë e zoklaturës, baza e altarit, muratura e harkuar e absidës dhe portiku hyrës.

## 10. Qendra Muzeore "Ndre Mjeda"

**Monument kulture kategoria II, i shpallur me vendim Nr. 95 datë. 16.10.1948/Nr. 6 datë. 15.01.1963/Nr. 1886 datë. 10.06.1983**

**Zonë e mbrojtur, i shpallur me vendim Nr. 53 datë. 22.02.2012**

**Fusha: Arkitekture; Gjinia: Kompleks; Tipologjia: Kishë-Qelë shek.XX 1906-1913**

**Njësia administrative: Bushat, Vendodhja: Kukël.**



**Fig. 10: Pamje nga Kompleksi Ndre Mjeda**

Ky objekt mori Statusin si Qendër Muzeore kushtuar Ndre Mjedës u shpall Monument kulture kategoria I me vendim nr. 95 date 16/10/1948 dhe vendim nr. 6 datë 15/01/1963 dhe vendim nr. 1886 date 10/06/1973. Së fundmi është shpallur zonë e mbrojtur me Vendim Nr.53 datë 22/02/2012. Kompleksi përbëhet nga kisha dhe nga qela (shtëpia ku ka banuar rreth 30 vite Ndre Mjeda) dhe ndodhet në fshatin Kukël të Njesisë Administrative Bushat. Kompleksi është ideuar dhe projektuar nga vetë Mjeda, sipas stilit neoklasik. Qela është e ndërtuar në vitin 1906 dhe kisha në vitin 1913.

Në vitin 1962, banesa u kthye në shtëpi-muze, si degë e Muzeut të Shkodrës, ku pati të ekspozuara pjesë nga gjërat personale të Mjedës, si materiale fotografike, shkrime studimore, botime librash etj. Në vitin 1991 shtëpia-muze "Ndre Mjeda" u mbyll dhe gjithë materialet e ekspozuara u dërguan në Muzeun Historik të Shkodrës. Në vitin 1993 në kishën e Kuklit shërbyen misionaret e Nënë Terezës, të cilët bënë një shtesë ngjitur me qelën nga ana e pasme e saj, si dhe në hapësirës ndërmjet kishës dhe qelës duke i lidhur këto dy objekte.

Banesa është e ndërtuar me mur guri dhe e mbuluar me çati me konstruksion druri dhe tjegulla vendi. Gjithashtu edhe ndërkati i banesës është i ndërtuar me konstruksion druri, trarë druri mbi të cilët është vendosur dysHEMEJA e drurit e katit të sipërm si dhe është fiksuar tavani i katit përdhe. DysHEMEJA e katit përdhe është e shtruar me çimento.

## **11. Rrënojat e Qendrës Zejtare të Punimit të Armëve**

**Monument kulture kategoria I, i shpallur me vendim Nr. 2509 datë. 30.06.1983**

**Fusha: Arkeologji; Gjinia: Vendbanim; Tipologjia: Vendbanim shek.XV-XVII**

**Njësia administrative: Bushat, Vendodhja: Kukël.**



**Fig. 11: Pamje nga rrënojat e qendrës zejtare të punimit të armëve**

Rrënojat e Qendrës Zejtare të Punimit të Armëve gjenden fshatin Hajmel dhe është shpallur Mo me vendim nr. 2509/1 datë 30/06/1983 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Kjo qendër zejtare e punimit të armëve i përket periudhës mesjetare, të shekullit XV-XVII. Për vendndodhjen e saj ka shumë pak informacion të saktë, pasi sot këto rrënoja pothuajse janë zhdukur.

## 12. Zona arkeologjike “A” dhe “B” e vendbanimit të Komanit (Dalmacia e vjetër) dhe rregullorja e Administrimit

Zone e mbrojtur, i shpallur me vendim Nr. 242 datë. 19.07.2016

Fusha: Arkeologji; Gjinia: Vendbanim; Tipologjia: Vendbanim shek. I

Njësia administrative: Temal, Vendodhja: Koman.



**Fig. 12: Zona arkeologjike A dhe B e vendbanimit të Komanit**

Komani, i cili ndodhet rreth 32 km në lindje të qytetit të Vau Dejes, është një zonë e thellë malore mes Pukës, Tropojës dhe Shkodres ku ndodhet hidrocentrali i Komanit si dhe fshati me të njëjtin emër.

Vendbanimi i Komanit i ka dhënë emër një qytetërimi të tërë mësjetar në Ballkanin perëndimor, ku pothuajse e gjithë shtrirja përkon në territorin Shqipëtar. Për ti paraprirë studimit është ndërtuar një projekt i madh arkeologjik që do të zgjasë me vite pikërisht për zbulimin e këtij vendbanimi të rrallë. Zbulimet tregojnë se bëhet fjalë për një qendër të shtrirë minimumi në 35 ha me një vitalitet ndërtimor dhe rëndësi banimi të jashtëzakonshme të pakten përgjatë 1000 viteve.

Rregullorja e Administrimit .

Qeveria shqipëtare ka shpallur zonat e vendbanimit të Komanit, si zona arkeologjike. “Në mbështetje të nenit 100 të “Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 2, të nenit 30, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave vendosi: 1. Shpalljen e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të Vendbanimit të Komanit (Dalmacia e Vjetër), sipas hartës dhe koordinatave gjeografike bashkëlidhur këtij vendimi. 2. Miratimin e rregullores “Për administrimin e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të Vendbanimit të Komanit (Dalmacia e Vjetër)”, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi”, thotë vendimi.

Me këtë akt, qeveria zyrtarizon mbrojtjen sipas ligjit të këtij vendbanimi, shumë i rëndësishëm për historinë e antikitetit të vonë dhe mesjetës së hershme në Shqipëri. Komani si vendbanim, i ka dhënë emrin Kulturës së Komanit, përdorur nga historiografia shqiptare dhe arkeologjia, si përkufizues i hipotezës së kalimit nga ilirët tek arbërit. Në zonën arkeologjike “A”, të Vendbanimit të Komanit (Dalmacija e Vjetër), lejohet: rikonstruksioni i rrugëve dhe punimet për rrjetet e infrastrukturës, mbi bazën e projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë, në vazhdim “KKA”, dhe nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në vazhdim “KKR”.

### 13. Rrënojat e Ipeshkëvisë së Sapës

Zone e mbrojtur, i shpallur me vendim Nr. 242 datë. 19.07.2016

Fusha: Arkitekture; Gjinia: Objekt kulti-Kishë; Tipologjia: Kishë

Njësia administrative: Hajmel, Vendodhja: Nënshat.



**Fig. 13: Pamje nga rrenojat e Ipeshvisë së Sapës**

Rrënojat e Ipeshkëvisë së Sapës ndodhet në rrëzën e malit të Shën Mëhillit, sot mali i Nënshatit, ngjitur me manastirin e motrave Karmelitane mbi fshatin Nënshat, Njësia Administrative Hajmel. Dioqeza e Sapës ka një histori 950 vjeçare dhe ajo ndodhej brenda qytetit më të njëjtin emër, i cili ishte dhe i fortifikuar. Pikërisht ky sistem mbrojtës njihej si Kalaja e Sapës.

Të dhënat e para për këtë qytet i kemi nga Annuali i Selisë së Shenjtë që në vitin 1062. Qyteti ngrihej në brendësi të malit të Shën Mëhillit (sot mali i Nënshatit) në një tarracë natyrore rreth 30 m pa mbërritur në majen e malit, duke i dhënë një mbrojtje të sigurtë ndaj sulmeve. Më vonë sipas dokumentave të kohës është Helena e Rashës e cila së bashku me Ipeshkvin e Tivarit i luten Papës që qytetin e Sapës ta shpallin Dioqeze të re së bashku me fushën e Zadrimës. Me 1292 qyteti digjet e shkatërrohet nga inkursionet e tartarve në Ballkan. Vetëm në 1491 do të rindërtohej sërish Kalaja e një pjesë e qytetit dhe Dioqeza e re tashmë do kishte nën varësi dhe atë të Danjes e Sardës të cilat ishin shkatërruar nga invazioni Osman.

Në vitin 1860 Ipeshkëvia u ringrit në rrëzë të malit ku vazhdon të jetë dhe sot, dhe në vitet '30 të shekullit të kaluar i nënshtrohet dhe një rikonstruksioni. Sot nga gjithë kompleksi i Ipeshkvisë së Sapës ruhet vetëm fasada ballore që ka një arkitekturë me ndikim të stilit gotik. Është e punuar me gurë të latuar të vendosur në mënyrë të rregullt dhe me elemente dekorative. Mbi portën kryesore ruhet një rozetë në gjendje të mirë. Aktualisht ka pësuar ndërhyrje në dritaret dhe portën hyrëse (duro-alumini) ngaqë brenda funksionon një urdhër kishtar.

#### 14. Kisha në fshatin Kaç (Proces shpallje me status Monument Kulture)

Proces shpallje me status Monument Kulture

Fusha: Arkitekture; Gjinia: Objek kulturi-kishë; Tipologjia: Kishë shek.XX

Njësia administrative: Vau-Dejes, Vendodhja: Kaç.



Fig. 14: Pamje nga Kisha në fshatin Kaç

Fshatrat Kaç dhe Naraç shrihen në pjesën verilindore të fushës së Zadrimës, aty ku shtrati i lumit Drin del nga pjesa malore për në fushë. Deri në fillim të shekullit XX aty kalonin edhe shtretërit e lumit Gjadër dhe përroit të Glinës që përmendën që në mesjetë bashkë me kishën në fjalë.

Kishën “*Shën Mëria e të ngjiturit në qiell*” e gjejmë të përmendur për herë të parë në relacionin e Arqipeshkëvit të Tivarit, Marin Bici në vitin 1610. Vikari i Dioqezës së Sapës Gjergj Bardhi shkruan në një tjetër relacion të vitit 1621 se “*Famullitar i kësaj Kishë është Pjetër Boza*”. Në një tjetër relacion të vitit 1632 Ipeshkëvi i Sapës Gjergj Bardhi shkruan se “*Kisha e Shën Mërisë kishte vreshhta dhe kujdestarët e saj*”. Në vitin 1638 Arqipeshkëvi i Tivarit shkruan se “*kjo kishë famullitare ka tre fshatra, Ranëzën, Hajmelin dhe Naraçin*”.

Ndërsa restaurimi i fundit i saj daton i vitit 1880 dhe ky fakt del nga relacioni i Ipeshkëvi Giulio Marsili. Në formën e saj origjinale e gjejmë dhe sot këtë kishë, pasi gjatë periudhës ateiste objekti ishte kthyer në depo bujqësore dhe gjatë kësaj periudhe iu hoqën këmbanorja, altari dhe instalime të ndryshme kishtarë në fasada.

Me gjithë ndryshimet objekti ruajti formën e plotë të tij kryesisht nga jashtë ku u ruajtën muret prej guri. Sot ky objekt kishtar i është rikthyer sërish Dioqezës së Sapës.



### **15. Fragmenti i thyerjes tektonike Shkoder-Peje**

Është ndër thyerjet më të mëdha tektonike në truallin shqipëtar që përshkruan territorin nga Shkodra në perendim deri në Peje (Kosove) në lindje dhe është shpallur Monument natyre kategoria III me VKM nr 676 date 20/12/2002. Përgjatë saj bëhet kontakti verior tektonik i shkëmbinjëve afitikë të zonës tektonike “Mirdita” me flashin e peleogenit të zonës tjetër tektonike të “Krastë-Cukalit”.Për shkak të riaktivizimit të saj rigjenerohen shpesh tërmete të fuqishme.Në palin tektonik ka shumë vizime horizontale të cilat janë rezultat i shtyrjeve të djathta të thyerjes Shkoder-Peje. Shprehja më e qartë e thyerjes është në fshatin Karmë. Ai është një monument gjeologjik (gjeomonument) me vlera të mëdha shkencore: gjeologjike dhe gjeomorfologjike. Vizitohet duke ndjekur rrugën automobilistike Vau i Dejes Koman.

### **16. Guri i Lekës**


Përfaqëson një kreshtë dhe një greminë të formuara në shkëmb gëlqëror. Gjendet në lartësinë e rreth 1200 m mbi nivelin e detit, pranë fshatit Malagji njësi administrative Temal dhe është shpallur Monument natyre kategoria III me VKM nr 676 date 20/12/2002. Gjatësia e saj është mbi 900 m, ndërsa lartësia arrin disa qindra metra. Ka vlera shkencore (gjeologjike dhe gjeomorfologjike), didaktike, turistike.

### **17. Bliret në Lisneqe**

Ndodhen në afërsi të fshatit lisneqe në stanet e bratit, 1000 m mbi nivelin e detit. Është shpallur Monument natyre kategoria III me VKM nr 676 date 20/12/2002.Përbën një grup drurësh me trung dhe kurorë të veçantë me lartësi 20 m dhe diametër të trungut 16 m dhe moshë mbi 120 vjeçare. Ka vlera shkencore (biologjike dhe ekologjike), kulturore, didaktike dhe turistike.

## 18. Shpella e Malagjisë

Ndodhet në afërsi të fshatit Malagji të njesise administrative Temal në faqen verilindore të malit të Cukalit në lartësinë 1300 m mbi nivelin e detit. Është shpallur Monument natyre kategoria III me VKM nr 676 date 20/12/2002. Është 180 m i gjatë, përbëhet nga disa galeri, që ndërthuren me hapsira më të gjëra dhe puse të shumtë dhe mjaft të thellë. Ka liqene të vegjel dhe konkrecione të shumta. Gjendja e saj është mjaft e mirë e ruajtur por rezikohet nga banoret vendas. Ka vlera shkencore, didakte dhe turistike.



## **19. Fusha e Liqethit**

Ndodhet në kreshtën e malit të Cukalit 1200 m mbi nivelin e detit, pranë fshatit lekgegaj njesia administrative Shllak dhe është shpallur Monument natyre kategoria III me VKM nr 676 date 20/12/2002. Përbën një gropë glacio-karstike të formuara në kryqëzimin e shkëputjeve tektonike dhe të modeluar nga karsti. Është i gjatë 1.3 km dhe i gjere deri në 1000 m ka formen e një erashke me disa forma më të vogla karstike. Në fundin e saj çakullime e bimësi barishtore dhe formohet një liqen i vogel gjatë shkërrjes së dëborës. Ka vlera shkencore (gjeomorfologjike) didaktike dhe turistike.

## **20. Liqeni Vau Dejës**

Është i pari liqen artificial që është ndërtuar në lumin Drin në vitin 1971, ka një sipërfaqe prej 24.7 km<sup>2</sup>, me një vëllim prej 580 milion m<sup>3</sup> uji. Gjatësia e liqenit është 10 km. Gjërësia e liqenit është 1.2 km. Thellësia më e madhe është 52 m. Lartësia absolute e sipërfaqes ( pasqyrës së ujërave ) është 74 m. Në të rriten lloje peshqish si trofta, ballëgjeri, krapi, etj.

## **21. Liqeni i Komanit**

Nëse dëshironi të bëni një shëtitje të paharrueshme përmes luginave, kanioneve e peizazheve të pazakonta, lundroni në Liqenin e Komanit, i cili ndodhet 30 km larg qytetit. Liqeni është formuar nga ujëmbledhësi i lumit Drin, ku është ngritur Hidrocentrali i Komanit me 600 mijë kw/orë. Liqeni ka sipërfaqe 12 km<sup>2</sup>, gjatësi 34.5 km, gjërësi 50-60 m. Rreth liqenit lartësohen male të pyllëzuara me lartësi 1000-1200 m mbi nivelin e detit. Ky rajon, veç vlerës turistike, ruan edhe vlera historike. Aty pranë ndodhet fshati Koman, ku është zbuluar një varrezë e shekullit 6-8 e.j., e cila lidhet me kulturën e shoqërisë së hershme shqiptare. Për t'i ardhur në ndihmë turistëve e vendasve, janë vënë në funksionim mjete lundrimi për pasagjerë, makina e mallra.